



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3806/1 Prot.

Tiranë, më 16.6.2023

URDHËR

Nr. 303, datë 16.6.2023

PËR

**NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT TË REKOMANDIMIT TË
LITERATURËS ARTISTIKE E LËNDËVE SHOQËRORE, DHE LITERATURËS
SHKENCORE, DIDAKTIKE PËR BIBLIOTEKAT E INSTITUCIONEVE
ARSIMORE PARAUNIVERSITARE PUBLIKE**

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 5 të nenit 16 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në nenin 26 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe në udhëzimin nr.34, datë 2.8.2013 “Për planifikimin e fondeve buxhetore dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit për blerjen e librave të bibliotekave të institucioneve arsimore publike”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Bordit të Rekomandimit të literaturës artistike e lëndëve shoqërore dhe literaturës shkencore, didaktike për bibliotekat e institucioneve arsimore parauniversitare publike, (në vijim Bordi) me përbërjen si më poshtë:
 - a) Shkëlqim Allkaj, kryetar;
 - b) Anila Ferizaj, anëtar;
 - c) Dorian Koçi, anëtar;
 - d) Alda Bardhyli, anëtar;
 - e) Adelina Mamaqi, anëtar;
 - f) Erida Koleci, anëtar;
 - g) Luljeta Dalipi, anëtar.
2. Bordi i Rekomandimit të literaturës artistike e lëndëve shoqërore dhe literaturës shkencore, didaktike për bibliotekat e institucioneve arsimore parauniversitare publike (shkollave), të kryejë funksionet si më poshtë:
 - a) Të hartojë listën me titujt e veprave të literaturës artistike, lëndëve shoqërore shkencore, didaktike, duke marrë parasysh propozimet e paraqitura nga shoqatat e

- botuesve, rrjetet profesionale të paraqitura pas kërkesës nga ministria përgjegjëse për arsimin, si dhe listën aktuale me titujt rekomandues për bibliotekat e shkollave.
- b) Të shqyrtojë, diskutojë dhe të vlerësojë, listën e titujve të literaturës artistike, lëndëve shoqërore dhe shkencore dhe didaktike vetëm për titujt e certifikuar për të drejtën e autorit të shtypur dhe/ose në variantin elektronik (*ebook*).
 - c) Të rekomandojë për t'u përfshirë në bibliotekat e shkollave, listën e titujve të literaturës, duke u bazuar në vlerat artistike, shkencore, didaktike, formuese dhe edukative, në përshtatje me grup-moshat, me kurrikulat e gjuhës shqipe, të letërsisë, të lëndëve të shkencave dhe atyre shoqërore si dhe me nevojat për kualifikimin e mësuesve.
 - d) T'i paraqesë për miratim ministrit të Arsimit dhe Sportit listën përfundimtare me titujt e literaturës së përzgjedhur deri në datën 20 korrik 2023.
4. Anëtarët e Bordit, para se të fillojnë punën, nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit.
 5. Pranë Bordit ngrihet Sekretariati Teknik me përbërjen e mëposhtme:
 - a) Florian Kasaj, anëtar;
 - b) Ergisa Bebja, anëtar;
 - c) Klea Shullazi, anëtar.
 6. Sekretariati i Bordit administron dokumentacionin, përgatit mbledhjet e Bordit dhe kryen detyra të tjera që lidhen me veprimtarinë e Bordit.
 7. Urdhri i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 291, datë 16.08.2021 "Për krijimin dhe funksionimin e Bordit të Rekomandimit të Literaturës Artistike dhe Lëndëve Shoqërore për bibliotekat e institucioneve arsimore parauniversitare publike" dhe urdhri i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 292, datë 16.08.2021 "Për krijimin dhe funksionimin e Bordit të Rekomandimit të Literaturës Shkencore dhe Didaktike për bibliotekat e institucioneve arsimore parauniversitare publike", shfuqizohen.
 8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit, Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore parauniversitare publike, Bordi dhe Sekretariati Teknik.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
EVIS KUSHI

